



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS**

**RAPORTI VJETOR 2007**

**DHE**

**SYNIMET KRYESORE PËR  
VITIN 2008**

Autoriteti i Konkurrencës  
Adresa: Rr. Sami Frashëri, nr. 4, Kati IV, Tiranë  
Tel: +355 4 234 504  
Fax: +355 4 234 497  
Faqe internetit: [caa.gov.al](http://caa.gov.al)  
Email: [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)

**PERMBAJTJA**

<b>I. Fjala e Hyrjes</b>	<b>4</b>
<b>II. Zhvillimet kryesore në fushën e konkurrencës dhe funksionimi i tregut</b>	<b>6</b>
<b>III. Organizimi dhe funksionimi i Autoritetit të Konkurrencës</b>	<b>10</b>
<b>III.1. Komisioni i Konkurrencës</b>	<b>10</b>
<b>III.2. Sekretariati</b>	<b>10</b>
III.2.1 Drejtoria e Mbikqyrjes se Tregut	11
III.2.2 Drejtoria e Çështjeve Juridike	12
III.2.3 Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Dokumentacionit	12
III.2.4 Sektori i Analizës dhe i Studimit të Tregut	13
<b>IV. Çështjet e ndjekura në zbatim të ligjit</b>	<b>14</b>
<b>IV.1. Abuzimi me pozitën dominuese</b>	<b>14</b>
IV.1.1 Mbi abuzimin me pozitën dominuese të AMC dhe Vodafone Albania	14
IV.1.2 Hapja e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Energjisë	16
IV.1.3 Ndërhyrja e Autoritetit të Konkurrencës në tregun e telefonisë fikse	16
IV.1.4 Mbi ekzistencën ose jo të pozitës dominuese të shoqërive “Profarma” sha dhe “Ajka” sha	18
<b>IV. 2. Marrëveshjet e ndaluara</b>	<b>18</b>
IV.2.1 Marrëveshja midis Prodhuesve të Betonit	19
IV.2.2 Hetimi i tregut të sigurimeve	19
IV.2.3. Marrëveshja mes prodhuesve të bukës	22
IV.2.4. Programi i lehtësimit nga gjobat	22
<b>IV.3. Kontrolli i Përqëndrimeve</b>	<b>22</b>
IV.3.1. Autorizime në sektorin financiar	23
IV.3.2. Autorizime në tregje të ndryshme:	24
<b>IV.4. Monitorimi dhe analizimi i kushteve të tregut</b>	<b>25</b>
<b>V. Çështjet Juridike, Integrimi Evropian, Përafrimi I Legjislacionit.</b>	<b>26</b>
<b>V.1. Vlerësimi legjislativ.</b>	<b>26</b>
<b>V.2 .Çështjet gjyqësore të konkurrencës.</b>	<b>27</b>
<b>V.3. Përafrimi i legjislacionit.</b>	<b>29</b>
<b>VI. Advokatia dhe Kultura e Konkurrencës</b>	<b>31</b>
<b>VII. Veprimtaria Ekonomike e Autoritetit të Konkurrencës</b>	<b>33</b>
<b>VII. 1. Fondi i pagave dhe kontributi i sigurimeve shoqërore</b>	<b>33</b>
<b>VII. 2. Materiale dhe shërbime të përgjithëshme</b>	<b>34</b>
<b>VII. 3. Mbi realizmin e investimeve</b>	<b>34</b>
<b>VIII. Bashkëpunimi me Institucionet dhe Entet Rregullatore</b>	<b>35</b>

<b>IX. Synimet kryesore të punës për vitin 2008</b>	<b>37</b>
<b>IX. 1. Rritja e kapaciteteve administrative</b>	<b>37</b>
<b>IX.2. Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor në kuadër të MSA-së</b>	<b>37</b>
<b>IX. 3. Monitorimi i tregut dhe hetimi i praktikave potenciale antikonkurruese</b>	<b>38</b>
IX.3.1 Hetimi i përgjithshëm në sektorin e energjisë	38
IX.3.2 Monitorimi i tregut financiar	39
IX.3.3 Hetimi i sektorit të telekomunikacioneve	39
IX.3.4 Monitorimi i tregut farmaceutik	40
IX.3.5 Ngritja e një sistemi të dhënash të monitorimit të tregut	40
<b>IX.4. Ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e konkurrencës</b>	<b>40</b>
<b>IX.5. Konsolidimi i marrëdhënieve ndërkombëtare të Autoritetit të Konkurrencës</b>	<b>41</b>

## **I. Fjala e Hyrjes**

Përbën një të vërtetë të pohuar se ekonomia shqiptare është një ekonomi e orientuar drejt tregut të lirë. Konkurrenca është një fenomen i pashmangshëm i tregut, realizimi me efektivitet i së cilës, kërkon kuadrin e vet ligjor dhe institucional. Ky kuadër realizohet nëpërmjet zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës, si një nga institucionet publike të angazhuara në mënyrë të drejtëpëdrejtë me krijimin e një sistemi, i cili garanton funksionimin e mekanizmave të tregut, synon mbrojtjen e konkurrencës në tregun e brendshëm nga shtrembërimet e praktikant anti-konkurrese, duke kontribuar për një ekonomi të lirë dhe funksionale të tregut.

Për forcimin e zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe të Politikës Kombëtare të Konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës e ka konsideruar të rëndësishme rritjen e advokatisë dhe të kulturës së konkurrencës, nëpërmjet rritjes së ndërhyrjes në treg për një lojë të barabartë midis operatorëve, transparencës në procedurat e ndjekura nga Sekretariati dhe vendimmarrjet e Komisionit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës ka përfunduar hetimet dhe ka realizuar për herë të parë vendimarrje të rëndësishme për praktikant anti-konkurrese, që bien ndesh me ligjin. Në vendimet e Komisionit të Konkurrencës janë argumentuar shkeljet e ligjit për abuzimin me pozitën dominuese apo për marrëveshjet e ndaluara. Parë në këtë kontekst, ndërhyrjet e Autoritetit të Konkurrencës për të siguruar konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, janë orientuar drejt sektorëve dhe tregjeve më të ndjeshëm ndaj deformimeve të konkurrencës. Tregu i telefonisë së lëvizshme, tregu i sigurimeve, sektori i ndërtimit e kryesisht tregu i prodhimit të betonit, tregu i prodhimit të bukës, janë dhe rastet më të rëndësishme të vendimarrjeve të Komisionit të Konkurrencës.

Gjatë procesit të vendimmarrjes, Komisioni i Autoritetit është bazuar në studimet dhe analizat ekonomike të realizuara nga Sekretariati si dhe seancat dëgjimore të organizuara me operatorët nën hetim. Organizimi i seancave dëgjimore dhe mundësimi i njohjes me dosjen e hetimit nga palët, përbën një risi tjetër që shpreh rritjen e transparencës në procedura si dhe në vendimarrje.

Autoriteti ka përmirësuar instrumentat e evidentimit të praktikave anti-konkurrese duke rritur shpejtësinë e veprimit, por ka aspekte që duhen konsoliduar, veçanërisht procedurat e investigimit.

Ekonomia shqiptare ka specifikat e saj si në lidhje me historinë e shkurtër të funksionimit, ashtu dhe me madhësinë dhe strukturën e tregut, apo mbizotërimin e biznesit të vogël dhe të mesëm. Kjo veçori e maturimit të ekonomisë është marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës, i cili ka marrë vendime në zbatim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe politikës kombëtare, si dhe bazuar në praktikat më të mira të Bashkimit Europian dhe të autoriteteve homologe.

Autoriteti i Konkurrencës ka ndërhyrë si duke marrë masat ndaj ndërmarrjeve ashtu dhe duke dhënë rekomandimet përkatëse për institucionet rregullatore për një liberalizim të mëtejshëm të ekonomisë dhe hapjen e saj drejt konkurrencës dhe konkurrueshmërisë.

Vetëm një ekonomi e hapur dhe konkurruese mund të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë dhe mirëqenie të rritur për të gjithë. Autoriteti është shprehur pro liberalizimit dhe hapjes drejt konkurrencës për ti siguruar biznesit privat dhe ndërmarrjeve publike kritere të njëjta të konkurrueshmërisë, sepse vetëm në këtë mënyrë do të realizohej vizioni i Komisionit të Konkurrencës, sipas të cilit konkurrenca sjell prosperitet.

Autoriteti i Konkurrencës ka hyrë në një fazë të re të funksionimit pasi ky instucion është sot shumë më i fuqizuar nga pikëpamja e personelit dhe i burimeve financiare. Ky fakt kërkon që Autoriteti të përmirësojë nivelin e ekspertizës në mënyrë që të veprojë si një institucion i pavarur në funksion të garantimit të barazisë midis operatorëve në treg.

Autoriteti i Konkurrencës ka rritur praninë e tij në tryezat rajonale të bashëpunimit nëpërmjet pjesëmarrjes aktive duke konsultuar eksepriencat e akumuluar me ato të autoriteteve homologe nga vendet e rajonit apo më gjere. Gjithashtu, janë paraqitur kontribute në publikimet e paraqitura nga; Global Competition Review; Competition and Antitrust Review, 2007 (Botim i Euromoney); Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës. Në këtë mënyrë Autoriteti i Konkurrencës ka realizuar konsultën me ekspertët ndërkombëtarë në lidhje me praktikat e ndjekura.

**Prof. Asoc.Dr. Lindita Milo (Lati)**

**Kryetare**

## **II. Zhvillimet kryesore në fushën e konkurrencës dhe funksionimi i tregut**

Gjatë vitit 2007 Autoriteti i Konkurrencës ka vepruar në zbatim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në mbështetje të dokumentit të Politikës Kombëtare të Konkurrencës të miratuar në fund të vitit 2006. Sfida kryesore e zbatimit të këtij dokumenti ishte ngritja dhe krijimi i kulturës për një konkurrence të lirë dhe efektive në treg, ndërgjegjësimi i komunitetit të biznesit dhe konsumatorëve për efektet pozitive që sjell konkurrenca në treg. Duke ndjekur me vëmendje zhvillimet në treg në aspektin e konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës ka arritur të mbyllë me sukses hetimet e nisura dhe të hapë një sërë hetimesh të reja në sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Në përgjithësi është arritur progres në fushën e konkurrencës dhe kjo është evidentuar edhe nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian.

Vizioni i Autoritetit të Konkurrencës ka qenë në të gjitha rastet vendosja e lojtarëve të tregut në kushte të barabarta dhe mbrojtja e interesave të cënuara të konsumatorëve nga sjelljet antikonkurrese të firmave që operojnë në treg.

Ndërhyrjet e Autoritetit të Konkurrencës për rivendosjen e konkurrencës në treg janë shtrirë në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë si telekomunikacioni, energjia dhe tregu financiar.

Komisioni i i Konkurrencës gjatë vitit 2007, në përfundim të hetimit në tregun e telefonisë së lëvizëshme, ka marrë një nga vendimet e tij më të rëndësishme përse i përket abuzimit me pozitën dominuese në këtë treg. Hetimi, që kishte filluar që në shtator 2005, u realizua ndaj dy kompanitë që vepronin në tregun përkatës gjatë periudhës në hetim AMC dhe Vodafone Albania. Me vendimin nr 59, datë 09 nëntor 2007 “Për abuzim me pozitën dominuese në Tregun e Telefonisë së Lëvizshme të Shoqërive Albanian Mobile Communication sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a.”, Komisioni i Konkurrencës gjobiti dyja shoqëritë në tregun përkatës për shumën 454 185 000 lekë.

Vetë Komisioni Evropian ka përshëndetur në raportin e progresit këtë hetim duke vlerësuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës mbi shkeljen e vërtetuar të ligjit, për abuzim me pozita dominuese nga dy kompanitë celulare dhe vendosjen e gjobave për shkelje të rregullave të konkurrencës.

Në lidhje më këtë hetim, Komisioni i Konkurrencës është shprehur edhe me Vendimin Nr 61 datë.21.11.2007, në të cilin i rekomandohet Këshillit të Ministrave dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve mbi marrjen e masave të menjëhershme për liberalizimin real të tregut të telefonisë së lëvizëshme nëpërmjet hyrjes në treg të operatorit të tretë dhe hapja e

procedurave për një licencë të katërt në tregun e Telefonisë së Lëvizshme, nisur nga radio-frekuencat e lëna në dispozicion në territorin e Shqipërisë. Këto rekomandime synojnë të forcojnë konkurrencën në tregun e telefonisë celulare për ti ofruar konsumatorit shërbime më cilësore me tarifa më të ulta.

Tregu i sigurimeve ka qenë gjithashtu gjatë vitit 2006 deri tremujorin e parë të 2007-tës nën hetim për shkak të disa praktikave të sjelljeve të koordinuara të tetë kompanive që ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë sektor.

Autoriteti i Konkurrencës konstatoi se (i) tregu i sigurimeve për “Përgjegjësinë Ndaj Palëve të Treta” (TPL) nuk është plotësisht i liberalizuar, (ii) koordinimi i sjelljes së operatorëve çon në fiksimin e çmimeve të policave të sigurimit të detyrueshëm, zbatimit të marrëveshjeve ekskluzive apo përzgjedhëse sipas produkteve të caktuara (TPL e brendshme, Polica e Sigurimit Kufitar, Kartoni Jeshil) dhe (iii) tregu i sigurimeve për TPL-në është i deformuar dhe me kufizime të konkurrencës.

Lidhur me marrëveshjen për tregtimin e Policës Kufitare të Sigurimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me dy vendime që (i) ndalon zbatimin e marrëveshjes dhe penalizon me gjobë shoqëritë e sigurimit dhe (ii) i rekomandon Ministrisë së Financave marrjen e masave për liberalizimin e tregut të këtij produkti si dhe shfuqizimin e urdherit të Ministrit të Financave mbi shitjen dhe administrimin e policës kufitare. Gjithashtu, i rekomandon Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare rregullimin e tregut bazuar në standarde dhe forcimin e kontrolleve dhe të sanksioneve për shkeljet..

Këto rekomandime u morrën në konsideratë me seriozitetin e duhur si nga Ministria e Financave ashtu edhe nga AMF-ja.

Por, vazhdimi i hetimit dhe i vendimmarrjes nga ana e Komisionit u pezullua me një vendim të Gjykatës së Tiranës. Për këtë arsye Autoriteti i Konkurrencës ka reaguar publikisht dhe institucionalisht pasi është cënuar misioni kryesor për të cilin është miratuar nga Kuvendi ligjit 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” mbi bazën e të cilit është ngritur dhe funksionon Autoriteti i Konkurrencës.

Një tjetër rast i ndërhyrjes së Autoritetit të Konkurrencës për rivendosjen e konkurrencës ka të bëjë me marrëveshjen midis 18 prodhuesve të betonit në Qarkun e Tiranës. Komisioni i Konkurrencës vendosi ndërprerjen e menjëhershme të marrëveshjes që synonte fiksimin e çmimit të markave të ndryshme të betonit dhe monitoroi me kujdes zhvillimet në këtë treg deri në mbylljen e hetimit. Bazuar në përfundimet e hetimit dhe në pretendimet e firmave të paraqitura në seancë dëgjimore të përgatitur nga Autoriteti, Komisioni i Konkurrencës vendosi gjobitjen e 9 kompanive prodhuese të betonit për shkak se nuk kanë dhënë informacionin e kërkuar nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës ka trajtuar marrëveshjen midis disa prodhuesve të vegjel të bukës në qarkun e Fierit, sipas të cilës (1) fiksohej çmimi i shitjes së bukës masive në 100 Lekë dhe (2) rrit çmimet e llojeve të tjera të bukës me rreth 17%. Gjatë procedurave hetimore, seancës dëgjimore dhe deklaratave të vetë kryetarit të shoqatës është konstatuar se ka qenë nxitësi dhe organizatori kryesor i kësaj marrëveshjeje. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, vendosi marrjen e masës së gjobës individuale ndaj Tij.

Një vendim i rëndësishëm i Komisionit të Konkurrencës për vitin 2007 ishte dhe hapja e hetimit të përgjithshëm në sektorin e energjisë. Ky hetim përfshin tre nëntregje: karburantet; gazin e lëngshëm dhe energjinë elektrike dhe ka për qëllim të vërtetojë nëse konkurrenca në këtë treg kufizohet apo shtrembërohet. Hetimi u ndërmor pasi nga monitorimet e mëparshme të Autoritetit në disa nënsektor të energjisë ekzistonin shenja të kufizimit dhe të shtrembërimit të konkurrencës.

Viti 2007 është konsideruar si viti i “valës” së shit/blerjeve dhe përqëndrimit të kapitalit kryesisht në tregun financiar (duke përfshirë tregun bankar dhe atë të sigurimeve). Autoriteti ka studjuar dhe ka miratuar tetë raste të shit/blerjeve dhe të përqëndrimeve.

Një zhvillim i rëndësishëm për Autoritetin e Konkurrencës gjatë vitit 2007 ishte dhe vendimi i Kuvendit për miratimin e strukturës së re të Autoritetit të Konkurrencës duke dyfishuar stafin në 35 punonjës. Funksionimi i Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës u bë më i plotë me kompozimin e tre drejtorive, Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtorisë Juridike dhe Integritit dhe Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Dokumentacionit si dhe Sektorin e Analizës dhe Studimit të tregut.

Gjatë vitit 2007 Autoriteti i Konkurrencës ka dhënë opinione dhe rekomandime për aktet ligjore dhe nënligjore në funksion të rritjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe po punon për miratimin e një udhëzuesi për vlerësimin e pasojave të legjislacionit mbi konkurrencën, i cili i adresohet të gjitha njësive parlamentare dhe qeveritare, si dhe enteve rregullatore sektoriale të cilat ndërmarrin hartimin e akteve normative.

Rritja e bashkëpunimit me entet rregullatore nëpërmjet nënshkrimit të memorandumeve të mirëkuptimit dhe gjetjen e instrumentave efikasë të ndërhyrjeve në sektorët e rregulluar të ekonomisë ka qenë një tjetër prioritet i Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2007. Bashkëpunimi me ERT, Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Entin Rregullator të Energjisë, Drejtorinë e Përgjithëshme të Doganave, Agjensinë e Prokurimeve Publike dhe institucione të tjera, ka shënuar progres dhe është vendosur mbi baza reciprociteti të shkëmbimit të informacioneve dhe dhënies së rekomandimeve për ndërmarrjen e masave që rivendosin konkurrencën në treg.



Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë, si Drejtorja e Përgjithshme e Konkurrencës në Komisionin Evropian, OECD, Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës dhe autoriteve homologe të rajonit, është ngritur në një tjetër stad gjatë vitit 2007.

### **III. Organizimi dhe funksionimi i Autoritetit të Konkurrencës**

Autoriteti i Konkurrencës është organ publik, i pavarur në kryerjen e detyrave të veta. Puna e Autoritetit të Konkurrencës mbështetet në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, si një e mirë publike.

Autoriteti i Konkurrencës nga pikëpamja organizative përbëhet nga Komisioni dhe Sekretariati. Komisioni përbëhet nga katër anëtarë dhe kryetari.

#### ***III.1. Komisioni i Konkurrencës***

Komisioni i Konkurrencës vepron si organ kolegjal, i përhershëm me mandat pesëvjeçar, i drejtuar nga Kryetari. Komisioni i Konkurrencës ka të gjitha kompetencat e nevojshme për marrjen e vendimeve, për çështje që kufizojnë, pengojnë apo deformojnë konkurrencën në treg, si për ndërmarrjet private ashtu dhe për ato publike, si dhe propozimin e mjeteve të nevojshme për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Komisioni vepron në zbatim të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, në mbështetje të Politikës Kombëtare të Konkurrencës e të detyrimeve në zbatim të Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit, dhe në frymën e standardeve europiane të konkurrencës.

Aktualisht Komisioni funksionon me katër anëtar kundrejt pesë anëtarëve që duhet të kishte në zbatim të ligjit. Autoriteti i Konkurrencës i është drejtuar disa herë institucioneve për plotësimin e Komisionit të Konkurrencës me anëtarin e pestë, pasi në këtë mënyrë sigurohet një vendimmarrje më e plotë e Komisionit, por deri më tani nuk ka patur asnjë zhvillim.

#### ***III.2. Sekretariati***

Sekretariati kryenë hetime administrative, sipas, ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi.

Sikurse është nënvizuar edhe nga vlerësimet e Komisionit Evropian, për vitin 2007, forcimi i kapaciteteve administrative ka qënë në vëmendje të Autoritetit të Konkurrencës, si nga pikëpamja e numrit dhe strukturës, ashtu edhe e formimit të tyre profesional, si faktorë bazë që sigurojnë rritjen e pavarësisë reale të këtij institucioni.

Në zbatim të detyrimeve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, Kuvendi dhe Qeveria kanë shprehur dhe konkretizuar mbështetjen e tyre për Autoritetin e Konkurrencës nëpërmjet miratimit të burimeve shtesë njerëzore dhe financiare për vitin 2007. Konkretisht, Autoritetit të Konkurrencës, gjatë vitit të ri buxhetor 2007 i janë shtuar 15 vetë, nga të cilët 12 vetë përbëjnë staf ekspertësh. Procesi i rekrutimit të stafit të ri u realizua gjatë periudhës Maj-Dhjetor të vitit të kaluar.

Struktura e re Sekretariatit të Konkurrencës e përcaktuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 96, date 30.04.2007, pasqyronë organizimin e ri në zbatim të tre shtyllave përbërëse të Ligjit. Gjithashtu, me synim rritjen e efektivitetit të funksionimit të Autoritetit dhe të përmirësimit të analizave ekonomike si paraprirese të procedurave investigative u krijua sektori i analizës dhe studimit të tregut.

Një përshkrim më të detajuar i pjesëve përbërëse të strukturës organizative të Sekretariatit, paraqitet si vijon:

### **III.2.1 Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut**

Drejtoria e Mbikqyrjes së Tregut, gjatë vitit të kaluar është konsoliduar nga pikëpamja organizative duke u formatuar sipas tre drejtimeve kryesore të ligjit në tre sektorë dhe konkretisht: Abuzimi me pozitën dominuese, Anti-karteli (marëveshjet e ndaluara) dhe Kontrolli i përqëndrimeve (i shit/blerjet në tregun e kapitalit që sjellin përqëndrimin në tregjet përkatëse). Ky departament realizon monitorimin, studimin dhe hetimin e tregut në këndvështrimin e analizës së efekteve ekonomike të praktikave antikonkurrese në situatat konkrete në treg, në zbatim të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe rregulloreve të miratuara nga Komisioni i Konkurrencës. Një nga sfidat kryesore të tij ka qënë përmirësimi i teknikave investigative si dhe rritja e shpejtësisë dhe efektivitetit në përpunimin e fakteve dhe evidencave.

Gjatë vitit 2007 nga kjo drejtori janë mundësuar ndërhyrje në disa nga tregjet, nëpërmjet kryerjes së analizave ekonomiko-financiare dhe hetime për identifikimin e praktikave anti konkurrese, apo të marrëveshjeve të ndaluara që dëmtojnë/ kërcënojnë/rrezikojnë të shtrembërojnë konkurrencën apo të krijojnë ose të forcojnë pozitën dominuese. Gjithashtu kjo drejtori kryen, analiza për vlerësimin e efekteve ekonomike që rrjedhin nga bashkimet apo shkrirjet e firmave që operojnë në te njëjtin treg apo tregje të ndërvarura.

### **III.2.2 Drejtoria e Çështjeve Juridike**

Drejtoria e Çështjeve Juridike si njesi organizative e Autoritetit, realizon në mënyrë të drejtëpërdrejtë përafrimin e legjislacionit të konkurrencës me atë të BE-së është organizuar në dy sektore: të Integritimit europian dhe atë të Hetimit e të çështjeve juridike. Ky departament funksion si pjesë integrale e Autoritetit duke realizuar veshjen juridike të procedurave që ndërmerr Drejtoria e Mbikëqyrjes si dhe se bashku me ekonomistet e grupeve te punës mundeson mbrojtjen të vendmeve të Komisionit të Konkurrencës kur keto ankimohen në gjykatë. Në këtë këndvështrim një nga sfidat kryesore të këtij departamenti ka qënë dhe mbetet përthithja e eksperinences së vëndeve të BE-së për argumentimin dhe paraqitjen e projekt-vendimeve që trajtojnë praktikat anti-konkurruese të vërtetuara.

Drejtoria e Çështjeve Juridike të ndjek legjislacionin dhe evidenton pjesët që bien ndesh me parimet dhe kërkesat e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe i propozon Komisionit të Konkurrencës ndryshimet përkatëse ligjore dhe nënligjore për arritjen e një konkurrence efektive, si dhe interpretimin ose bazueshmërinë ligjore të akteve normative në përgjithësi dhe atyre të AK-së në veçanti.

### **III.2.3 Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Dokumentacionit**

Një ndër prioritetet më emergjente afat shkurtra në Autoritetin e Konkurrencës për vitin 2007 ka qënë rritja e kapaciteteve institucionale, për të siguruar një institucion të përgjegjshëm dhe transparent në zbatimin e ligjit për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Organizimi i ri i institucionit kërkoi menjëherë hartimin e përshkrimeve të punës dhe përcaktimin e kërkesave të veçanta për pozicionet e reja dhe ato të ristrukturuara. Gjatë periudhës Maj - Dhjetor 2007, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Dokumentacionit ka realizuar 20 procedura rekrutimi nga të cilat 17 procedura pranimi në shërbimin civil dhe tre lëvizje paralele. Rekrutimi i stafit të kualifikuar është bërë sipas kërkesave dhe procedurave të të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i Nënpunësit Civil", nenet 10 dhe 13

Plotësimi i strukturës kryesisht me staf te ri kërkon dhe realizimin e një sërë trajnimesh si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Gjatë vitit 2007 punonjësit e Autoritetit të Konkurrencës kanë marrë pjesë në një sërë aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare, si seminare, Workshope, konferenca etj., ku kanë përfutuar eksperiencë të vlefshme në fushën e konkurrencës. Këto aktivitete janë financuar nga Institutin e Trajnimeve te Administrates Publike, OECD, TAEIX, si dhe nga Autoriteti i Konkurrencës.

Një drejtim tjetër i punës së kësaj drejtorie është mbulimi i veprimtarisë financiare të Autoritetit dhe mbajtja e përgjegjësisë së plotë për të gjitha problemet që kanë të bëjnë me administrimin e fondeve të buxhetit, konform legjislacionit për menaxhimin e buxhetit të Shtetit Shqiptar. Kjo drejtori, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera përgatit projekt-buxhetin e Autoritetit të Konkurrencës për miratim, mban llogaritë e shpenzimeve dhe të të ardhurave faktike, kryen analizat e përdorimit të fondeve buxhetore në përputhje me legjislacionin shqiptar të kontabilitetit

### **III.2.4 Sektori i Analizës dhe i Studimit të Tregut**

Në bazë të vendimit nr.96 datë 30.04.2007 për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës, është krijuar Sektori i Studimit dhe Analizës. Misioni i këtij sektori është kryerja e analizave ekonomike të strukturave të ndryshme të tregjeve konkrete dhe identifikimi fillestar i formave antikonkurrese në këto tregje, në zbatim të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Nëpërmjet analizave të kryera nga ky sektor synohet të krijohet një pamje e përgjithshme e tregut , dhe informacioni i nxjerrë në formën e raporteve prej sektorit të shërbejë si ndihmesë për sektorët e tjerë të Autoritetit të Konkurrencës.

## **IV. Çështjet e ndjekura në zbatim të ligjit**

Në dispozitat e Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" janë shprehur qartë, procedurat që mundësojnë investigimin e abuzimit me pozicionin dominues, marrëveshjeve të ndaluara, dhe kontrollin e përqendrimeve, si dhe gjobat e sanksionet në rastin e shkeljes së këtij ligji.

Në vijim të këtij raporti paraqiten çështjet e trajtuara gjatë vitit të kaluar të grupuara sipas tre drejtimeve të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës:

### **IV.1. Abuzimi me pozitën dominuese**

Ligji për mbrojtjen e konkurrencës ndalon abuzimin me pozitën dominuese dhe jo pozitën dominuese në vetvete. Ligji ndalon çdo abuzim nga një ose më shumë ndërmarrje me pozitë dominuese në treg, në mënyrë të veçantë në rastet e vendosjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të blerjes ose të shitjes, ose të kushteve të tjera të padrejta të tregtimit.

#### **IV.1.1 Mbi abuzimin me pozitën dominuese të AMC dhe Vodafone Albania**

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2007 ka përfunduar hetimin për abuzimin me pozitën dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme. Palët e përfshira në këtë hetim ishin dy kompanitë që veprojnë në tregun shqiptar, AMC dhe Vodafon. Autoriteti i Konkurrencës ka informuar në raportin vjetor të vitit 2006 mbi ecurinë e procedurës së hetimit në këtë treg që ka filluar me nismën e vetë Autoritetit të Konkurrencës në muajin shtator 2005.

Komisioni i Konkurrencës vërtetoi që AMC dhe Vodafon zotërojnë një pozitë dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme dhe se të dy kompanitë kishin abuzuar me pozicionin e tyre në këtë treg gjatë periudhës 2004-2005.

Sipas nenit 9, pika 2, germa a, një ndër format kryesore të abuzimit me pozitën dominuese është zbatimi i çmimeve të padrejta prej tyre. Çmimi i praktikuar është i padrejtë kur ai është shumë më i lartë se çdo të ishte në një treg konkurrues.

Për të vlerësuar karakterin e padrejtë të çmimit, në radhë të parë mund të krahasohet niveli i çmimit me vlerën ekonomike të produktit, ose e thënë ndryshe me koston e tij. Në radhë të dytë, dhe në pamundësi për të përcaktuar koston e prodhimit, niveli i çmimit në treg, si dhe norma e fitimit, mund të krahasohet me nivelin e çmimit ose të fitimit të produkteve të krahasueshme apo me çmimin dhe normën e fitimit të të njëjtëve produkte në tregje gjeografike të ndryshme. Për këtë arsye Autoriteti i Konkurrencës përdori tre teste:

1. Vendosja e çmimeve të larta pa lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit;
2. Sigurimi i përfitimeve tregtare, të cilat nuk do të siguroheshin në një treg të prezumuar konkurrues;
3. Krahasimi i tarifave me tregje të tjera gjeografike.

Nga zbatimi këtyre testeve Komisioni i Konkurrencës arriti në përfundimin se:

Të dy kompanitë që operojnë në tregun e telefonisë së lëvizëshme kanë pozitë dominuese në treg dhe kanë abuzuar duke aplikuar tarifa të padrejta në tregun përkatës gjatë periudhës objekt hetimi 2004-2005.

Mbi këtë bazë Komisioni i Konkurrencës vendosi të gjobit shoqërinë Albania Mobile Communication sh.a. (AMC) me 2% të xhiros vjetore të produktit përkatës të vitit 2005, që e shprehur në vlerë është 211 552 000 lekë, dhe shoqërinë Vodafone Albania sh.a. me 2% të xhiros vjetore të produktit përkatës të vitit 2005, që e shprehur në vlerë është 242 633 000 lekë.

Shoqëritë AMC sh.a dhe Vodafone Albania e kanë apeluar vendimin në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë dhe procedurat gjyqësore do të vazhdojnë gjatë vitit 2008.

Mbështetur në hetimin në tregun e telefonisë së lëvizshme Autoriteti i Konkurrencës mori vendimin nr 61, "Për Disa Rekomandime për Tregun e Telefonisë së Lëvizshme". Meqenëse tregu i telefonisë së lëvizëshme është një treg i rregulluar nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Këshillit të Ministrave dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve liberalizimin e tregut të telefonisë së lëvizshme, nëpërmjet hyrjes në treg të operatorit të tretë, "Eagle Mobile" brenda afatit ligjor të parashikuar në kriteret e licencës dhe hapjen e procedurave për një licencë të katërt në tregun e Telefonisë së Lëvizshme, nisur nga radiofrekuencat e lëna në dispozicion në territorin e Shqipërisë.

Në këtë vendim i është rekomanduar ERT-së që dispozitat mbi Operatorët me Fuqi të Ndjeshme në Treg në ligjin nr. 8618, date 14.06.2000 "Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë" të përshtaten me Strukturën Rregullatore për Konumikimet Elektronike të BE-së, sidomos me Direktivat e Vitit 2002. Gjithashtu, Kreu XII që i takon inspektiveve, mbikëqyrjes dhe masave administrative duhen rishikuar me synim forcimin e gjobave ndaj kundravajtjeve administrative të kryera nga operatorët.

Komisioni i Konkurrencës është shprehur mbi domosdoshmërinë e hartimit të Metodologjinë e Rregullimit të Tarifave të përdoruesve dhe të interkoneksionit të dy operatorëve celularë, të shpallur OFNT, dhe mbi rritjen e transparencës dhe respektimin e parimit e mosdiskriminimit mes operatorëve të tregut të telefonisë për marrëveshjet e interkoneksionit. Gjithashtu, i është rekomanduar Enti Rregullator i Telekomunikacioneve që duhet të ndërhyjë që marrëveshjet për interkoneksionin të mos cenojnë parimet e konkurrencës në tregun e telekomunikacioneve.

Institucionet e mesipërme i janë përgjigjur rekomandime duke hartuar dhe publikuar rregulloret përkatëse.

#### **IV.1.2 Hapja e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Energjisë**

Me vendimin Nr. 60, datë 12.11.2007, Komisioni i Konkurrencës ka hapur hetimin përgjithshëm në sektorin e energjisë. Ky hetim do të përfshijë tre nëntregje: karburantet; gazin e lëngshëm dhe energjinë elektrike për të vërtetuar nëse konkurrenca në këtë treg kufizohet apo shtrembërohet. Hetim u ndërmor pasi nga monitorimet e mëparshme të Autoritetit në disa nënsektor të energjisë rezultoi se kishte shënja të kufizimit dhe të shtrembërimit të konkurrencës. Për më tepër, ka një shqetësim të vazhdueshëm të konsumatorit dhe institucioneve publike mbi sjelljen e ndërmarrjeve që veprojnë në këtë treg. Duke marrë në konsideratë faktin që këto nëntregje janë zëvendësues në një farë mase të njëri-tjetrit, si dhe zhvillimet e pritshme në nëntregun e energjisë elektrike, hetimi i përgjithshëm përfshiu të gjithë sektorin. Për kryerjen e hetimit është ngritur një grup pune me përbërjen e punonjësve të Autoritetit dhe për një fazë të dytë është siguruar edhe mbështetja me ekspertë të huaj nëpërmjet TAIEK.

#### **IV.1.3 Ndërhyrja e Autoritetit të Konkurrencës në tregun e telefonisë fikse**

Gjatë vitit 2007 pati zhvillime të rëndësishme në sektorin e telekomunikacioneve, Shitja e paketës prej 70 për qind të aksioneve të kompanisë publike “Albtelekom” dhe ndryshimi i pronarit të operatorit të tretë të telefonisë celulare “Eagle Mobile” krijoi mundësi për investime të reja në këtë treg.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm në tregun e telefonisë gjatë vitit 2007 ishte liberalizimi i telefonisë fikse edhe në zonat urbane. Si pasojë e këtij liberalizimi shumë operatorë alternativ që ofronin shërbimin e tyre vetëm në zonat rurale kanë aplikuar për një ndryshim të licencave të tyre duke kërkuar që të ofrojnë shërbimet edhe në zonat urbane. Ky liberalizim shënon hapjen e këtij sektori kundrejt konkurrencës dhe do të ketë efekte në rritjen e cilësisë së shërbimit dhe uljen e tarifave të komunikimit.



Megjithatë, liberalizimi i tregut i shoqëruar me tranzicionin e kalimit të pronësisë së “Albtelekom” krijuan një sërë problemesh që prekin konkurrencën në këtë treg midis Operatorëve me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe operatorëve alternativë. Autoriteti i Konkurrencës ka marrë disa ankesa nga shoqëri të ndryshme dhe nga Shoqata e Operatorëve Alternativë kundrejt Albtelekom, por edhe kundrejt dy shoqërive të telefonisë së lëvizshme AMC dhe Vodafone.

Ankesën e parë Autoriteti e ka marrë nga shoqëria “Nisatel”, si shoqëria e parë e licensuar për ofrimin e shërbimit të telefonisë në zonën urbane të Vlorës, me pretendimin se Albtelekom është duke abuzuar me pozicionin e vetë dominues duke mos lidhur marrëveshjen e interkonjeksionit me “Nisatel”.

Pas marrjes së ankesës, Autoriteti i Konkurrencës ndër morri veprime duke iu adresuar shoqërive Albtelekom dhe Nisatel, me përfaqësuesit e të cilëve u organizuan disa takime. Meqenëse ceshtja lidhej me interpretimin e treguesve teknik si dhe me veprimtarinë e Entin Rregullator të Telekomunikacioneve u realizuan tryeza konsultative me këtë institucion, duke synuar ndërhyrjen e menjëhershme për mundësimin e marrëveshjes së interkoneksionit brenda muajit Dhjetor midis dy palëve. Autoriteti i Konkurrencës kërkoi zbatimin e plotë të ligjit nr 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” që i detyron ndërmarrjet me pozitë dominuese në treg të ofrojnë shërbime me kushte jodiskriminuese për operatorët e tjerë me synimin që tregu të hapet për konkurrencë.

Si rezultat i ndërhyrjes së Autoritetit të Konkurrencës, takime u arrit që të bindeshin të dyja palët të uleshin në bisedime, të cilat bënë të mundur nënshkrimin e një marrëveshje paraprake interkonjeksioni në datë 31.12.2007. Kjo marrëveshje përbën dhe modelin e marrëveshjeve të interkoneksionit që do të nënshkruajë Albtelekom me të gjithë operatorët alternativë të licensuar për ofrimin e shërbimeve të telefonisë në zonat urbane dhe ato rurale.

Kjo çështje përbën një nga rastet e para kur një biznes ankohet ndaj një biznesi tjetër për praktika antikonkurrese, fakt që shpreh besimin në rritje të biznesit vëndas ndaj AK-së si dhe përgjegjësinë e rritjes së efincencës nga ky institucion. Autoriteti i Konkurrencës ka marrë edhe ankesa të tjera nga operatorët alternativë dhe nga shoqata e tyre që kanë të bëjnë kryesisht me marrëveshjet e interkonjeksionit. Enti Rregullator i Telekomunikacioneve ka miratuar një rregullore të plotë për rregullimin e këtyre marrëdhënieve, duke përcaktuar edhe një afat për lidhjen e marrëveshjes së interkonjeksionit. Në këto kushte Autoriteti është në pritje të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga kjo rregullore, duke e mbjatur në vëzhgim të vazhdueshëm sektorin e telekomunikacioneve.

#### **IV.1.4 Mbi ekzistencën ose jo të pozitës dominuese të shoqërive “Profarma” sha dhe “Ajka” sha**

Më kërkesë të Inspektoriatit të Verifikimit të pasurisë Autoriteti ka bërë edhe një vlerësim të pozitës dominuese të shoqërive “Profarma” dhe “Ajka”. Për të bërë këtë vlerësim Autoriteti realizoi një analizë të tregut të përpunimit të qumështit dhe të tregut farmaceutik. Pas analizës së këtyre tregjeve Autoriteti gjeti se të dyja shoqëritë nuk zotërojnë një pozitë dominuese në tregjet përkatëse.

#### **IV. 2. Marrëveshjet e ndaluara**

Në zbatim të ligjit nr 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,(neni 4) Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2007 ka ndjekur me vëmendje zhvillimet në treg duke evidentuar, ndaluar dhe marrë vendimet respektive për rastet e marrëveshjeve midis ndërmarrjeve që përcaktojnë çmime të fiksuara duke vepruar si një organizëm(grupim ndërmarrjesh) i vetëm dhe çënojnë në këtë mënyrë konkurrencën e lirë në treg duke dalë jashtë objektivit të shoqatave të biznesit.

Autoriteti i Konkurrencës iu është drejtuar disa herë bizneseve dhe shoqatave që mbrojnë interesat e tyre se realizimi i marrëveshjeve të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrëmbërimin e konkurrencës është një akt i dëmshëm dhe në kundërshtim me ligjin “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Spektori i Anti Kartel ka synuar arritjen e objektivit për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, duke vepruar kryesisht ndaj kufizimeve të konkurrencës, si në rritjen dhe fiksimin e çmimeve dhe kushteve të tjera të tregtimit ndaj konsumatorit

Analiza e rasteve të marrëveshjeve horizontale që fiksojnë çmimet është bërë sipas praktikave më të mira të Komisionit Evropian duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të ekonomisë së vendit tonë. Evidentimi i kushteve të tregut për zbulimin e këtyre marrëveshjeve si dhe analiza e dëmit ndaj konsumatorit është parë si një tregues që i shërben interesit të përgjithshëm publik, zhvillimit të ekonomisë dhe mbrojtjes së konsumatorit në veçanti.

Çështjet kryesore që ka ndjekur Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” kanë qënë:

#### **IV.2.1 Marrëveshja midis Prodhuesve të Betonit**

Autoriteti i Konkurrencës në bazë të informacioneve të siguruara nëpërmjet shtypit të shkruar dhe medias elektronike, u vu në dijeni të ekzistencës së një marrëveshje në qarkun e Tiranës të nënshkruar nga anëtarët e Unionit të Prodhimit të Betonit (18 ndërmarrje të prodhimit të betonit). Marrëveshja fiksonte çmimin e shitjes së betonit dhe vendoste kushte të paratregtimit, Këto praktika bien ndesh me dispozitat e ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Marrëveshja e nënshkruar nga ndërmarrjet prodhuese të betonit u gjet në kundërshtim me ligjin pasi ka shkelje të nenit 4, pika 1, germa a) të ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” . Kjo marrëveshje kufizon haptazi konkurrencën e lirë duke caktuar drejtpërdrejtë çmimin e shitjes me vlera fikse si dhe vendos kushte të cilat nuk kanë lidhje me objektin e kontratës. Autoriteti i Konkurrencës ka kërkuar që palët duhet të jenë të lira të negociojnë për çmimet ose kushte të tjera të shitblerjes pa iu vendosur kushte shtesë që nuk kanë lidhje me objektin e kontratës.

Në vazhdim të procedurave të hetimit, grupi i punës vazhdoi monitorimin e këtij tregu për të parë efektet e mundshme të shkaktuara në këtë treg nga vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 56, datë 24.09.2007 “Për ndalimin e Marrëveshjes në Tregun e Prodhimit të Betonit në Qarkun e Tiranës”. Nga ky monitorim u konstatua se firmat ndërtuese blejnë beton të çmimeve të ndryshme nga ndërmarrjet prodhuese të betonit.

Në zbatim të procedurave, Komisioni i Konkurrencës organizoi një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e ndërmarrjeve prodhuese të betonit në qarkun e Tiranës. Pasi shqyrtoi raportin e Sekretariatit dhe pretendimet e palëve, Komisioni i Konkurrencës arriti në konkluzionin se marrëveshja nuk është zbatuar në praktik nga ana e ndërmarrjeve antare të Unionit të Prodhuesve të Betonit. Në vijueshmëri të procedurave, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2007, Komisioni i Konkurrencës vendosi gjobitjen e 9 kompanive prodhuese të betonit për shkak se nuk kanë dhënë informacionin e kërkuar nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës. Në bazë të ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 73, pika 1, një veprim i tillë konsiderohet si shkelje e lehtë

#### **IV.2.2 Hetimi i tregut të sigurimeve**

Gjatë viteve të fundit Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur hapat ligjor për hetimin në sektorin financiar, konkretisht në tregun e sigurimeve.

Në zbatim të Ligjit 9121, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës ka konstatuar se (i) tregu i sigurimeve për “Përgjegjësinë Ndaj Palëve të Treta” (TPL) nuk është plotësisht i liberalizuar, (ii) koordinimi i sjelljes së operatorëve çon në fiksimin e çmimeve të policave të sigurimit të detyrueshëm, zbatimit të marrëveshjeve ekskluzive apo përzgjedhëse sipas produkteve të caktuara (TPL, Polica e Sigurimit Kufitar, Kartoni Jeshil) dhe (iii) tregu i sigurimeve për TPL-në është i deformuar dhe me kufizime të konkurrencës.

Për këto arsye, Autoriteti i Autoritetit të Konkurrencës vendosi hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun e Sigurimeve dhe konkretisht në produktet e TPL-së (Kartonit Jeshil, Sigurimin Kufitar dhe TPL-në e brendshme).

Duke përcaktuar të ndara tregjet përkatëse për të tre produktet e sigurimit të detyrueshëm, Autoriteti i Konkurrencës ndoqi procedura të vecanta hetimi dhe arriti të shprehet me vendim vetëm për Policën Kufitare të Sigurimit.

Shoqëritë e sigurimit, megjithëse ishin vënë në dijeni për hetimin dhe ishin ftuar të jepnin pretendimet e tyre rreth çështjes, në bazë të nenit 39 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, refuzuan të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës dhe apeluan vendimin nr 45, dt 19.01.2007 të Komisionit të Konkurrencës për hapjen e hetimit të thelluar në tregun e sigurimit për produktin e Përgjegjësisë ndaj Palëve të Tjera(TPL)-TPL e brendshme, Policë Kufitare, Karton Jeshil).

Lidhur me marrëveshjen për tregtimin e POOL-it të Sigurimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me dy vendime që ndalon zbatimin e marrëveshjes dhe penalizon me gjobë shoqëritë e sigurimit dhe vendimi i dytë që i rekomandon Ministrisë së Financave marrjen e masave për liberalizimin e tregut të këtij produkti.

Në zbatim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, Komisioni i Konkurrencës, vendosi ndalimin e akt-marrëveshjes së datës 05.04.2005 “Mbi themelimin e Pool-it të Sigurimit Kufitar të Përgjegjësisë ndaj palëve të treta të mbajtësit të mjetit motorrik”, (vendimi Nr 50 datë 21.03.2007). Kjo marrëveshje ishte lidhur nga e lidhur nga 8 (tetë) shoqëri sigurimi, që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimeve dhe konkretisht: Sigma Sh.a, Sigal Sh.a, Atlantik Sh.a, Intersig Sh.a, Interbalkan Sh.a, Albsig Sh.a, Eurosig sh.a (ish Dukagjini Sh.a), si dhe Insig Sh.a, u gjykua si marrëveshje e ndaluar me pasoja kufizuese për konkurrencën, mbasi fikson çmimin dhe ndan tregun. Si rrjedhojë Komisioni i Konkurrencës vendosi gjobë në masën 2% të xhiros të vitit 2005, ndaj secilës prej shoqërive pjesëmarrëse në marrëveshjen dhe konkretisht:

Shoqëritë e sigurimit e kanë apeluar vendimin e mësipërm pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë dhe çështja është ende në gjykim (ka gati një vit që çështja nuk ka filluar të gjykohet në themel, për shkak të zvarritjeve të palëve dhe të gjyqësorit)

Në zbatim të ligjit Komisioni i Konkurrencës morri Vendimi nr. 49 datë 21.03.2007 "Për rekomandime të ndryshimeve në disa akte normative në fushën e sigurimeve". Në këtë vendim KK-ja i rekomandoi Ministrin të Financave shfuqizimin e plotë të Urdhërit "Mbi shitjen dhe administrimin e policës kufitare nga BSHS" dhe urdhërave të tjerë në zbatim të tij, që lidhen me shpërndarjen e të ardhurave nga shitja e policës kufitare. Këto akte nënligjore formalizonin marrëveshjen me objekt dhe pasoj kufizimin e marrëveshjes .

Për herë të parë Ministria e Financave reagoi pozitivisht ndaj rekomandimeve të vendimit të Komisionit të Konkurrencës dhe në zbatim të këtij vendimi Ministri i Financave nxorri Urdhërin nr. 69, datë 17.7.2007 "Për prodhimin, emetimin, administrimin dhe shitjen e policave kufitare të sigurimit". Autoriteti i Konkurrencës e përshendeti nxjerrjen e këtij urdhëri, pasi nëpërmjet këtij urdhëri realizohet vendimi i Autoritetit të Konkurrencës për ndalimin e praktikave antikonkurrese të zbatuara në tregun e sigurimeve, që shkelnin nenin 4 të ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës", nëpërmjet ndarjes së tregut, fiksimit të çmimit dhe kufizimit të ofertës në një agjent të vetëm.

Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës i rekomandoi Autoritetit përgjegjës për mbikqyrjen e tregut të sigurimeve, AMF-së që të rregullojë tregun e policave të sigurimit të detyrueshëm, nëpërmjet vendosjes së kontrollit dhe standarteve, si dhe zbatimi i sanksioneve në rastet e shkeljeve të vërejtura me qëllim shmangien e informalitetit në tregun e sigurimeve. .

Autoriteti i Konkurrencës me kënaqësi vëren rritjen e efikasitetit të vendimmarrjes së Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës që synon në vendosjen e standardeve për funksionimin e tregut të sigurimeve. Këto standarde janë konsideruar si kusht i domosdoshëm për funksionimin e bizneseve në tregun përkatës.

Por, duhet nënvizuar se rasti i hetimit të mëtejshëm të tregut të sigurimeve për sigurimin e detyrueshëm dhe shitjen e kartonit jeshil, dhe TPL, ku Autoriteti i Konkurrencës ka vërejtur se është cënuar konkurrenca. është ndërprerë që nga muaji mars 2007 për shkak të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë. Ky vendim i gjykatës anulon tërësisht Vendimin nr.45, datë 19.01.2007 të Komisionit të Konkurrencës "Për hapjen e Hetimit të Thelluar në tregun e sigurimeve", dhe në këtë mënyrë ka paralizuar punën e institucionit të pavarur të Autoritetit të Konkurrencës, të ngritur pikërisht për mbrojtjen dhe rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Autoriteti i Konkurrencës ka reaguar lidhur me këtë vendimin të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Autoriteti i Konkurrencës ka apeluar vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë për vendimin e paprecedent të Gjykatës së Rrethit Tiranë,.

#### **IV.2.3. Marrëveshja mes prodhuesve të bukës**

Një rast tjetër marrëveshjeve të ndaluar të trajtuar nga Autoriteti i Konkurrencës lidhet me marrëveshjen midis disa prodhuesve të vegjel të bukës në qarkun e Fierit, sipas të cilës (i) fiksohej çmimi i shitjes së bukës masive në 100 Lekë dhe (ii) rriteshin çmimet e llojeve të tjera të bukës me rreth 17%.

Marrëveshja, që ka hyrë në fuqi që me datë 16.08.2007 përbën shkelje të rëndë të konkurrencës pasi grupimi i ndërmarrjeve eliminon konkurrencën midis tyre duke fiksuar çmimin e shitjes, veprim që bie ndesh me nenin 4/a të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe përbën shkelje të rëndë. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, vendosi ndalimin e Marrëveshjes së lidhur më datë 08.08.2007 midis ndërmarrjeve prodhuese të bukës në Qarkun e Fierit.

Gjatë procedurave hetimore, seancës dëgjimore dhe deklaratave të vetë kryetarit të shoqatës Z. Kajo Hallka është konstatuar se ai ka qenë nxitësi dhe organizatori kryesor i kësaj marrëveshje. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, vendosi marrjen e masës së gjobës individuale ndaj Z. Kajo Hallka në masën 30.000 lekë.

#### **IV.2.4. Programi i lehtësimit nga gjobat**

Në të gjitha praktikat e ndjekura nga sektori Anti Kartel (marrëveshjeve të ndaluara), ky sektor në korrespondencën e dërguar krahas kërkesave për informacion ka dërguar dhe programin e lehtësimeve nga gjobat për reduktimin e plotë ose të pjesshëm të gjobave të vëna për ndërmarrjet, të cilat bashkëveprojnë me Autoritetin e Konkurrencës në hetimet e marrëveshjeve të ndaluara. Sipas këtij programi ndërmarrjet e përfshira në këto lloj marrëveshjesh mund t'i japin fund pjesëmarrjes së tyre dhe të evitojnë aplikimin e gjobës, duke ofruar provat lidhur me çështjen në investigim. Por deri tani nuk është evidentuar ndonjë rast bashkepunimi nëatënivel qe të plotësohen parimet e programit të lehtësimit të gjobave.

#### **IV.3. Kontrolli i Përqëndrimeve**

Eksperiencia e deritanishme e Autoritetit të Konkurrencës ka krijuar një pikëpamje të qartë se në fushën e zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator të konkurrencës një rol të rëndësishëm po merr kontrolli i përqëndrimeve të ndërmarrjeve. Nëpërmjet kontrollit të përqëndrimeve, Autoriteti i

Konkurrencës, synon të ndikojë në zhvillimet e strukturave të tregut duke ndaluar apo kufizuar ato përqendrime që mund të krijojnë ose të forcojnë pozitën dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, duke e kufizuar ndjeshëm konkurrencën efektive të tregut.

Gjatë vitit 2007, në tregun financiar kanë ndodhur ndryshime strukturore, që lidhen me rritjen e konkurrencës në treg Ky vit është karakterizuar nga një zhvillim dinamik i tregut bankar. Kjo dinamik shfaqet në ndryshimet strukturore, hyrjen dhe zgjerimin e kapitalit të huaj në treg, ndryshimet në pronësinë e aktorëve të tregut, dhe është reflektuar në aplikimet për njoftim të përqendrimeve të bëra pranë Autoritetit të Konkurrencës. Për të gjitha rastet e shqyrtuara, Autoriteti ka bashkëpunuar me Departamentin e Mbikqyrjes së Bankës e Shqipërisë, si Autoriteti Rregullator në tregun bankar dhe Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare, si rregullatori në sektorin e sigurimeve.

#### **IV.3.1. Autorizime në sektorin financiar**

1. Me vendimin Nr 51, datë 9.5.2007, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqëndrimin e realizuar, nëpërmjet transaksionit të shitblerjes së 80% të kapitalit aksionar dhe të së drejtës së votës në Bankën Amerikane të Shqipërisë nga shoqëria Intesa SanPaolo Spa, aksioneri kontrollues në Bankën Italo Shqiptare. Me realizimin e këtij përqendrimi pritët të rritet konkurrenca ndaj bankës kryesore (Raiffeissen bank) në tregun kombëtar. Kjo konkurrence prek aseteteve, tregut të depozitave dhe te bonove të thesarit, duke krijuar në këtë mënyrë dy konkurrentë të fortë që ndiqen nga 14 banka të tjera, që kanë një rol të rëndësishëm në konkurrencën në tregun përkatës si atë e kombëtar, por edhe në atë ndërkombëtar.
2. Me Vendimin Nr.52 datë 21.06 2007, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqëndrimin e realizuar, nëpërmjet transaksionit të shitblerjes së 75.006% të kapitalit aksionar dhe të së drejtës së votës në Bankën Popullore nga shoqëria Societe General SA., pjesë e grupit bankar me qendër në Francë.
3. Me Vendimin Nr. 64, datë 3.12.2007, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqëndrimin e realizuar, nëpërmjet transaksionit të blerjes së të realizuar së pjesës në total të 36.25% në ProCredit Bank Sh.A nga shoqëria ProCredit Holding AG”, pjesë e grupit Procredit në Gjermani. Në zbatim të procedurës për kontrollin e përqendrimeve, të parashikuara nga ligji (nenet 53-63), rezultoi se pavarësisht se përqendrimi nuk sillte ndonjë ndryshim në strukturën e tregut bankar, informacioni i siguruar nga pala njoftuese ProCredit Bank, lidhur me datën e nënshkrimit të marrëveshjes nuk ishte i saktë dhe i plotë,. Në këtë kontekst, Komisioni

në përputhje me nenin 73 të ligjit, me vendimin nr 63, datë 3.12.2007, gjoboti shoqërinë ProCredit Holding AG me 7 milion lekë.

4. Me Vendimin Nr. 65, datë 11.12.2007, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqëndrimin e realizuar, nëpërmjet bashkimit sipas procedurës së përthithjes të Bankës Amerikane të Shqipërisë me Bankën Italo Shqiptare. Kjo formë përqendrimi nëpërmjet përthithjes shkaktoi që Banka Italo Shqiptare të pushoi së ekzistuari si person juridik, duke u krijuar një bankë e re, me të njëjtin emër: Banka Amerikane e Shqipërisë. Bashkimi i këtyre bankave rrit fuqinë në treg të bankës së re BAA, duke e renditur atë në vend të dytë pas Raiffeisen bank. I parë në këndvështrimin e eficensës së tregut, forcimi i pozicionit në treg të bankës së re BAA pas përqendrimin, nuk e kufizon ndjeshëm konkurrencën në treg dhe sjell përfitime për klientët. Futja e shërbimeve/produkteve të reja, përmirësimi i atyre ekzistuese, krijimi i sinergjive, nga ulja e shpenzimeve dhe rritja e të ardhurave, zhvillimi i teknologjive të informacionit, etj., janë tregues prokonkurrues që tejkalojnë pasojat që rrjedhin nga forcimi i pozicionit në treg të BAA-së.
5. Me Vendimin nr 55, datë 11.09.2007, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqëndrimin e realizuar, nëpërmjet blerjes së 75%+1 të aksioneve në shoqërinë Sigma Sh.A nga shoqëria TBH Financial Servis Group N.V. Ky është përqëndrimi i parë i autorizuar në tregun e sigurimeve dhe përbën një zhvillim pozitiv për tregun shqiptar, pasi hyrja e një grupi të fuqishëm financiar nga një vend i Bashkimit Evropian pritet të përmirësojë standartet e shërbimit dhe të rrisë konkurrencën në këtë treg. Shoqëria Sigma sha mban vendin e tretë përse i përket vëllimit të primeve të nënshkruara për vitin 2006 (viti para ndodhjes së përqendrimin) dhe ka shtrirje me degët/filialet e saj edhe në Maqedoni dhe Kosovë. E veçanta e këtij rasti është ndërthurja me një treg tjetër, atë të pensioneve private dhe suplementare, i cili është ende në fazat embrionale.

#### **IV.3.2. Autorizime në tregje të ndryshme:**

Ligji “Për Mbrojtjen e Konkurrencës zbatohet jo vetëm ndaj aktorëve të pranishëm në tregun shqiptar, që me veprimtarinë e tyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë prishin ekuilibrat e konkurrencës në treg, por edhe ndaj atyre shoqërive që veprojnë jashtë tregut kombëtar, por që pasojat e tyre ndihen në tregun shqiptar. Në këtë kontekst:

6. Me Vendimin nr. 48, datë 21.03.2007, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqëndrimin e realizuar, nëpërmjet blerjes 100% të aksioneve në shoqërinë Gallaher Group plc nga Japan Tabaco Inc. Theksojmë se të dyja këto shoqëri janë të pranishme në tregun shqiptar të duhan



cigareve, nëpërmjet shpërndarësive ekskluzivë të autorizuar nga vetë ata, si Primal Trading dhe Kuinda Shpk.

7. Me Vendimin Nr.53, datë 12.07.2007, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 30% të aksioneve të shoqërisë Strabag SE nga Rasperia Trading Limited”, me qendër në Limassol, Qipro. Ky përqëndrim nuk shkakton kufizim apo ndonjë efekt të kundërt për konkurrencën në tregun kombëtar të ndërtimit, si në nivel horizontal ashtu edhe vertikal, për dy arsye: Së pari, kemi një treg gjeografik të kufizuar, ku pjesa e tregut që zotëron një nga palët pjesëmarrëse në transaksionin e përqëndrimit është rreth 5%. Së dyti, tregu i produkteve të ofruara nga palët pjesëmarrëse është i ndryshëm si në nivel horizontal ashtu dhe në nivel vertikal.
8. Me Vendimin Nr. 54, datë 04..09.2007, Komisioni i Konkurrencës, autorizoi përqëndrimin e realizuar, nëpërmjet blerjes së 76% të aksioneve në shoqërinë Albtelekom ShA nga Calik Energji Telekomunikation (CETEL). Konkurrenca në tregun e telefonisë fikse është e kufizuar për shkak të dominimit të tregut nga një operator i vetëm dhe mungesës së konkurrentëve të fuqishëm në këtë treg. Autoritetit i Konkurrencës në përmbushje të misionit të tij, do të ndjekë me vëmendje sjelljen e shoqërisë në treg, për të shmangur kufizimin, pengimin apo deformimin e konkurrencës në treg. Ndërkohë, transaksioni pritet të sjellë ndryshime strukturale përsa i takon tregut të telefonisë së lëvizshme, nga ushtrimi i veprimtarisë së Eagle Mobil dhe pritet të rrisë konkurrencën në këtë treg ku aktualisht veprojnë vetëm dy operatorë.

#### ***IV.4. Monitorimi dhe analizimi i kushteve të tregut***

Në bazë të vendimit nr.96 datë 30.04.2007 për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës, ka nisur punën Sektori i Studimit dhe Analizës. Duke qenë një sektor i sapo krijuar, ai është angazhuar kryesisht me monitorimin dhe studimin e tregut energjitik dhe në atë financiar..

## **V. Çështjet Juridike, Integrimi Evropian, Përafrimi I Legjislacionit.**

### ***V.1. Vlerësimi legjislativ.***

Autoriteti i Konkurrencës, gjatë vitit 2007, ka respektuar detyrimet ligjore në drejtim të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Kjo mbrojtje është fokusuar konkretisht edhe në aspektin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimet e dispozitave të pikës 2, të nenit 62 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”(i ndryshuar). Në këtë kuadër Autoriteti i Konkurrencës ka dhënë kontributin e tij në vlerësimin e shkallës së shtrembërimit dhe kufizimit të konkurrencës, që rrjedh nga projekt-aktet ligjore dhe nënligjore, për të cilat është kërkuar mendim pranë tij , ose edhe në rastet kur vetë Autoriteti me nismën e tij, ka konstatuar shtrembërime ose pengime të konkurrencës në akte të ndryshme normative.

Autoriteti u është drejtuar institucioneve dhe strukturave përkatëse shtetërore që për çdo akt, i cili potencialisht mund të kishte ndikim në funksionimin e tregut, apo që prek elementet e konkurrencës ti drejtoheshin Autoritetit të Konkurrencës. Në këtë mënyrë, mund të realizohet ndërhyrja ex-ante e Autoritetit duke u shprehur dhe duke u marrë në konsideratë nga hartuesit e akteve ligjore dhe nënligjore, pr respektimin e rregullave të lojës në treg duke siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive.

Autoriteti ka vlerësuar shkallën e kufizimit ose të shtrembërimit të konkurrencës të projekt-akteve të mëposhtme dhe konkretisht është shprehur:

- Për Projekt – vendimin “Për dhënien me qera ose enfiteozë të pasurive të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore”,
- Mbi projekt-ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8701, datë 01.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet” të ndryshuar”, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
- Mbi projekt-ligjin “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, (METE)
- Për Projektin mbi Rregullat dhe Procedurat të Shitjes së Energjisë Elektrike ,

- Mbi projekt-ligjin “Për transmetimet numerike eksperimentale në Republikën e Shqipërisë”,
- Për projekt-ligjin “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”,
- Mbi Projekt – Ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8518, datë 30.07.1999 “Për Ujitjen dhe Kullimin”, (Ministria e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit)
- Mbi projekt-vendimin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 463, datë 05.07.2006 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”, (Ministria e Integritimit)
- Mbi projekt-ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9362, datë 24.03.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”, (MBUMK)
- Mbi Projekt-Ligjin “Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare”,(METE)
- Autoriteti i Konkurrencës ka shprehur mendimin e vet, në objekt të punës së tij, edhe për Projekt-Vendimin “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, nëpunësve të kabineteve dhe punonjësve mbështetës në administratën e disa institucioneve të pavarura”. (Ministria e Brendshme)

Në përputhje me detyrimet ligjore dhe pikërisht nenin 82 të ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” AK-ja ka mundur të bashkëpunim me GTZ të konsolidojë metodologjinë e vlerësimit të akteve normative në fuqi. Në përmbushjen e këtij procesi AK-ja ka përgatitur matricën për vlerësimin e legjislacionit që prek fushën e konkurrencës.

Gjithashtu, bazuar në këtë bashkëpunim, është hartuar udhëzuesi “Për Vlerësimin e pasojave të legjislacionit mbi konkurrencën” i cili do të thjeshtojë zbatimin e nenit 69 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Nnëpërmjet këtij udhëzuesi organet e administratës qendrore dhe vendore do të mund të vlerësojnë rastet se kur duhet të kërkojnë vlerësimin e AK-së për çdo projekt-akt normativ. Autoriteti i Konkurrencës e ka përcjellë këtë udhëzues si material rekomandues nëpër institucione për të lehtësuar punën e hartuesve të këtyre akteve në përputhje me kërkesat e ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

## ***V.2 .Çështjet gjyqësore të konkurrencës.***

Në zbatim të detyrave të tij ligjore, Autoriteti i Konkurrencës në përfundim të hetimeve nëtregje dhe sektorë të ndryshem të ekonomisë ka aplikuar sanksione, të cilat kanë prekur interesat ekonomike të palëve të prekura. Si

rrjedhoj, këto vendime të Komisionit të Konkurrencës janë kundërshtuar nga ana e palëve.

Gjatë vitit të kaluar, Autoriteti i Konkurrencës ka paraqitur dhe ka mbrojtur vendimet e tij para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe asaj të Apelit, në rastet kur këto akte administrative të Komisionit janë kundërshtuar me padi gjyqësore nga palët e prekura në to.

Departamenti juridik nuk mund të relizojë mbrojtjen e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës nëse nuk është pjesë integrale e gjithë procesit të hetimit dhe të argumentimit të vendimeve. Nëpërmjet pjesëmarrjes së juristëve të Departamentit të Integritetit dhe të Cështjeve Juridike në grupet e punës së hetimeve të ndërmarra nga Sekretariati i Autoritetit mundësohet përmirësimi i praktikave të argumentimit juridik të raporteve të hetimit dhe të projektvendimeve. Kjo gjithahstu ndihmon në fazën e mbrojtjes juridike të projektvendimit para Komisionit të Konkurrencës. Si dhe mbrojtjen në sallën e gjyqit e cila është një mbrojtje e *tretë* që i behet një vendimi të Komisionit të Konkurrencës.

Në përfundim të hetimit të thelluar në tregun e sigurimeve, Autoriteti i Konkurrencës u ndesh me dy padi gjyqësore me shoqëritë objekt-hetimi të këtij tregu. Vlen të përmendet fakti se: edhe grupi i hetimit, edhe Komisioni i Konkurrencës para marrjes së vendimit përfundimtar i ftoi palët nën hetim në seanca dëgjimore për t'u dhënë mundësinë e shprehjes së pretendimeve të tyre në lidhje me hetimin, faktet e dala prej tij dhe raportin e hetimit. Por për arsyen e përmendur më lart të një mungese të njohjes së procedurave të ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" palët nuk e gjykuan të arsyeshme të paraqisnin argumentet e tyre, por gjeten si rrugë më të shkurtër, atë më të njohur dhe me klasike të paditjes së Autoritetit të Konkurrencës në gjykatë. Padija e pare me këto subjekte kishte të bënte me anulimin e vendimit të Komisionit për hapjen e hetimit të thelluar nga ana e Autoritetit në këtë treg. Në këtë padi edhe gjykata shpeshherë ishte e paqarte se çfarë procedure kishte hapur konkretisht autoriteti dhe çfarë pasoje sillte ajo. Në këtë mënyrë ajo me pranimin e padisë automatikisht bllokoi pjesërisht hetimin në këtë treg, bllokim, i cili vazhdon deri në çastin e shqyrtimit të ankesës së Autoritetit në Apel. Pas marrjes së Vendimit të Komisionit për gjobitjen e shoqërive të tregut të Sigurimeve me 2% të xhiros vjetore, Autoriteti u përball përsëri në gjykatë me këto subjekte. Çështja vazhdon të zhvillohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Deri në përfundim të 2007 Autoriteti ishte në proces gjyqësor me AMC sh.a. në Gjykatën e Apelit Tiranë për gjobën në masën 1% të xhiros dhe ndërkohe pret po pranë kësaj gjykate zhvillimin e gjyqit me të njëjtin subjekt për ankesën e tij të fundit për rrëzimin e padisë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për deklarimin e pavlefshëm të hetimit të thelluar në tregun e telefonisë së lëvizshme.

Njekohesisht edhe ne procesin gjyqesor te hapur nga Calik Sheker Yatirim kundra gjobes se Autoritetit, ky i fundit ka fituar ne te dy shkallet e gjyqesorit ndaj padise se Calikut. Padia eshte rrezuar si ne gjykate te rrethit gjyqesor ashtu dhe ne ate te Apelit.. Aktualisht, ky proces është fituar nga Autoriteti i Konkurrencës.

### ***V.3. Përafrimi i legjislacionit.***

Në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës ka vazhduar ta fokusojë punën edhe në procesin e përafrimit të akteve ligjore dhe nënligjore të legjislacionit vendas me atë të BE-së. Gjatë vitit 2007 AK-ja ka punuar drejt plotësimit dhe hartimit të legjislacionit sekondar në fushën e konkurrencës në përputhshmëri me aktet e nevojshme legjislative të Bashkimit Evropian

Nga takimi BE-Shqipëri i zhvilluar në Bruksel në Mars 2007 u diskutua dhe u vlerësua puna e kryer nga AK-ja në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit në fushën e konkurrencës, të procedurave investiguese në praktikant anti-konkurrese dhe veçanërisht në tregun e telefonisë së lëvizshme dhe të sigurimit të detyrueshëm të automjeteve. Ekspertët e BE-së vlerësuan rritjen e kapaciteteve institucionale të AK-së si një faktor i rëndësishëm në ecurinë e punëve.

Nga takimi i 11 BE- Shqipëri (Nëntor) të zhvilluar në Tiranë, (joint committee) u vlerësua puna e kryer nga Autoriteti i Konkurrencës në drejtim të zbatimit të ligjit të konkurrencës, në lidhje me vendimet të marra nga Komisioni i Konkurrencës për hetimet në tregun e telefonisë së lëvizshme dhe në tregun e sigurimit të detyrueshëm. Ekspertët e BE-së vlerësuan punën e bërë në kuadër të respektimit të detyrimeve ligjore të përcaktuara në MSA për sa i përket procesit të përfarimit dhe përshtatjes së legjislacionit evropian në fushën e konkurrencës dhe në drejtim të përshpejtimit të këtij procesi.

Nëpërmjet progres raporteve mujore, tremujore dhe vjetore dërguar Ministrisë së Integritimit, Autoriteti i Konkurrencës ka raportuar kryerjen e angazhimeve të ndërmarra në zbatim të MSA-së. AK-ja ka punuar për përshtatjen e rregulloreve të Komisionit Evropian dhe konkretisht të rregullores së EC-së nr. 139/2004 “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, të rregullores së EC nr. 802/2004 “Në zbatim të rregullores së Këshillit nr. 139/2004 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” etj. Këto rregullore do të gjejnë pasqyrim në amendimin e rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” dhe në një paketë ligjore (rregullore, udhëzues, formularë, njoftime) për sektorin e përqendrimeve. Kjo paketë është në përputhje me *Acquis Communautaire* dhe synon përmirësimin e procedurave të përqendrimit dhe përafrimin e tyre me

procedurat që ndjekin Autoritetet e Konkurrencës së vendeve të BE-së, rritjen e transparencës në marrëdhëniet midis Autoritetit të Konkurrencës dhe palëve të treta të interesuara për procedurat e kontrollit të përqendrimeve, lehtësimin e këtyre procedurave, etj. Procesi i përafrimit të legjislacionit në fushën e përqendrimeve ka kaluar në një proces diskutimi me studiot ligjore dhe palë të treta të interesuara duke marrë mendimet e tyre , vërejtjet dhe sugjerimet në lidhje me këtë paketë aktesh nënligjore.

Komisioni i Konkurrencës ka miratuar rregulloren e re të brendshme ‘Për Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës’ ku është synuar përshtatja e saj në zbatim të Ligjit organik të Autoritetit të Konkurrencës, të Politikës Kombëtare të Konkurrencës, si dhe të rregullores 1/2003 të KE-së “Për implementimin e rregullave në zbatim të nenit 81 dhe 82 të traktatit Evropian” etj. Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e saktë të procedurave hetimore në përputhje me rregullat e funksionimit dhe organizimin e Autoritetit të Konkurrencës, në përputhje me procedurat hetimore që ndjekin autoritetet homologe të konkurrencës, sqaron kompetencat e Komisionit të Konkurrencës dhe ato të Sekretariatit (në përputhje me ligjin).

Duke synuar drejt një sjelljeje korrekte dhe etikë të lartë profesionale dhe shoqërore, është përgatitur dhe miratuar “Kodi i Etikës së Autoritetit të Konkurrencës” ku janë përcaktuar rregullat e etikës që duhet të zbatojnë nëpunësit e Autoritetit në punën e tyre, në përputhje me Ligjin Nr 9131 ,datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës Administratën Publike”, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “ Për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike” etj, si dhe janë pasqyruar parimet në përputhje me Kodet e Etikës së Autoriteteve të Konkurrencës së vendeve të Bashkimit Evropian.

## **VI. Advokatia dhe Kultura e Konkurrencës**

Në zbatim të Politikës Kombëtare të Konkurrencës edhe gjatë vitit 2007 një ndërr veprimtaritë kryesore të Autoritetit ka qënë avokatia e konkurrencës dhe krijimi i kulturrës së konkurrencës.

Puna e Autoritetit te konkurrencës i kulturrës së konkurrencës për vitin 2007 ne procesin e avokatisë se konkurrencës u përqendrua kryesisht ne:

1. Rritjen e transparencës së procedurave të ndjekura nga Autoriteti si dhe organizimi me seriozitetin e duhur të seancave dëgjimore jo vetem per palët ne hetim por edhe ftesa per gjithë palët e interesura për proceset e shit/blerjeve dhe të përqëndrimeve. Transparenca e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës nëpërmjet publikimit dhe botimit të tyre në kohë reale, intervistat e në të cilat paraqiten mesazhet e Autoritetit të Konkurrencës për monitorimet dhe procedurat hetimore të ndërmarra, pjesëmarrja në debate publike mbi çështje të funksionimit të konkurrencës.
2. Gjatë vitit 2007, Autoriteti i Konkurrencës ka luajtur një rol aktiv për njohjen e grupeve të ndryshme të interesit, biznesit, konsumatorëve, medias, universiteteve me rolin dhe rëndësinë e funksionimit të ligjit dhe politikës së konkurrencës. Gjithashtu, janë ndërmarrë veprime për rritjen e nivelit të profesionalizmit, transparencës dhe përgjegjshmërisë së Autoritetit të Konkurrencës në zbatimin e ligjit për një treg që funksionon me konkurrencë të lirë dhe efektive, nëpërmjet pjesëmarrjes në Workshop, trajtime konferencash etj.
3. Përkthimin dhe botimin e literaturës shpjeguese te termave te konkurrencës dhe konkretisht te “Fjalorit Terminologjik te Konkurrencës”. Ky botim u realizua me ndihmën dhe sponsorizimin e GTZ-se. Përkthimi i këtij fjalori u realizua nga botimi ne anglisht i te njëjtit material te Fjalorit te Drejtorisë se Përgjithshme te Konkurrencës ne KE, dhe synon jo vetëm përdorimin nga specialistet dhe stafet e Autoritetit të Konkurrencës for edhe nga komuniteti i juriteve, biznesit, edukimit..
4. Botimin për herë të parë të Buletinet Zyrtare te Autoritetit te Konkurrencës 2004-2007, në të cilën botohen te gjithë vendimet e Komisionit te Konkurrencës për gjithë periudhën e funksionimit të tij.
5. Rritja se tepërmi e transparencës me publikun ne përgjithësi dhe palët e interesuara ne veçanti është mundësuar edhe nëpërmjet faqes zyrtare të internetit dhe publikimit në të të të gjithave vendimeve të Komisionit të Konkurrencës. Faqja e rinovuar e internetit është shumë dinamik në gjuhën Shqipe dhe në Anglisht, dhe konsiderohet si mjet

informimi dhe konsultimi me palet e interesit dhe autoritet homologe. Falë tematikës së prekur nga Autoriteti, çështjet e konkurrencës janë parë gjithnjë e më shumë me interes nga mediat e shkruara dhe elektronike, të cilat e konsiderojnë faqen elektronike si burim të informacionit në kohë reale.

6. Përmirësimin e punës për informimin e biznesit dhe të gjithë opinionit publik për njohjen e akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e konkurrencës, duke rritur bashkëpunimin me subjektet që ushtrojnë veprimtari në treg dhe duke konsideruar median si një faktor të rëndësishëm në përcjelljen në publik të politikave kombëtare të konkurrencës.



## **VII. Veprimtaria Ekonomike e Autoritetit të Konkurrencës**

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2007 ka zbatuar me korektësi kërkesat e Ligjit nr, 9645, datë 27.11.2006 “ Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007” në lidhje me përdorimin e fondeve buxhetore

Administrimi i vlerave materiale e monetare është konsideruar një fushë e rëndësishme e punës tonë duke zbatuar me korektësi të gjitha aktet ligjore e nënligjore dhe normativat në përdorimin e fondeve buxhetore. Puna në sektorin e financës është e lidhur me operacionet financiare, si dhe ndjekjen dhe mirëadministrimin e shpenzimeve buxhetore dhe investimeve të cilat janë të lidhura me veprimtarine e institucionit. Gjithashtu, ajo ka siguruar të dhëna për veprimtarinë financiare, si dhe ka përcaktuar e ndjekur realizimin e shpenzimeve, të ardhurat, rritjen e aktiveve të institucionit. Në tërsinë e vetë ky sektor ka ndikuar në përmirësimin dhe arritjen e objektivave dhe detyrave që ka institucioni jonë.

Buxheti vjetor për financimin e veprimtarisë së Autoritetit, i cili përbën zë më vete në buxhetin e shtetit, miratohet nga Kuvendi. Të ardhurat që krijohen në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, përfshirë dhe të ardhurat nga gjobat, derdhen në buxhetin e shtetit.

Një përmbledhje e treguesve buxhetorë të vitit 2007 paraqiten si me poshtë:

Nr	E m ë r t i m i	Plan	Fakt	Diferenca	Në %
1.	Fond page, kontribute Sig. Shoq.	35.724	28.255	- 7469	79
2.	Materiale dhe shërbime të përgjithëshme	12.035	11.610	- 425	96.5
3.	Investime	4.721	4.668	- 53	99
<b>TOTALI</b>		<b>52.480</b>	<b>44.533</b>	<b>- 7947</b>	<b>85 %</b>

Të dhënat financiare tregojnë një realizim prej 85 % .

### **VII. 1. Fondi i pagave dhe kontributi i sigurimeve shoqërore**

Fondi i pagave i planifikuar për Autoritetin e Konkurrencës ishte 35.724 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 28.255 mijë lekë ose 79 % me një diferencë më pak nga programimi prej 7469 mijë lekë. Ky mosrealizim ka ardhur nga mungesa e numrit të punonjësve gjatë vitit dhe kryesisht në 6 mujorin e parë Gjatë realizimit të këtij elementi buxhetor janë zbatuar kërkesat e të VKM nr 450, datë 14.06.2006, nr.475, date 13.07.2007, nr 477, date 13.07.2007 dhe të Ligjit nr 9584 datë 17.07.2006 “ Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe te institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj. Gjithashtu, janë ndalur dhe derdhur kontributet e

sigurimeve shoqërore, shendetësore dhe tatimi i pagës për çdo punonjës sipas udhëzimeve përkatëse.

## **VII. 2. Materiale dhe shërbime të përgjithëshme**

Për materiale dhe shërbime të përgjithëshme ishin parashikuar 12.035 mijë lekë, të cilat janë realizuar në vlerën 11.610 mijë lekë ose 90.6 % , me një diferencë me pak nga plani prej 425 mijë lekë. Ky mosrealizim ka ardhur kryesisht nga fondet e pa përdorura për udhëtim e dieta, shërbime telefonike etj

Gjatë vitit 2007 i është kushtuar rëndësi zbatimit të ligjit për dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare. Në blerjet me vlera të vogla janë zbatuar më korektësi kërkesat e ligjit nr 9643, date 20.11.2006 “ Për Prokurimin Publik” dhe për blerjet e tjera mbi kufirin 400 mijë lekë janë zhvilluar proceset e tenderimeve konforme kërkesave të dispozitave ligjore.

## **VII. 3. Mbi realizimin e investimeve**

Për investimet nga 4.721 mijë lekë të planifikuara në fillimin e vitit janë realizuar 4.668 mijë lekë ose 99. %. Fondet e përdorura për investime janë kryesisht për, pajisje dhe orendi zyrash, kompjutera e pajisje kompjuterike, blerje gjeneratori, rikonstruksion të pjesshëm të zyrave, instalim i sistemit audio në sallën e konferencave, etj. të nevojshme për krijimin e kushteve të punës së punonjësve të administratës së Autoritetit të Konkurrencës.

## **VIII. Bashkëpunimi me Institucionet dhe Entet Rregullatore**

Autoriteti i Konkurrencës vlerëson si një aspekt të rëndësishëm marrëdhëniet me institucionet e administratës publike qendrore dhe vendore në përgjithësi dhe entet rregullatorë në veçanti, duke respektuar kështu edhe dispozitat ligjore respektive. Bashkëpunimi synon ndërtimin e marrëdhënieve më të ngushta të bashkëpunimit midis institucioneve respektive, shkëmbimin e informacioneve dhe të eksperiencës duke respektuar dispozitat ligjore përkatëse, rritjen e transparencës, forcimin e kapaciteteve, trajnime të përbashkëta, krijimin e grupeve të përbashkëta të punës për çështje të caktuara etj, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Në këtë këndvështrim, gjatë vitit 2007 AK-ja ka synuar drejt një bashkëpunimi më të ngushtë me disa nga sektorët rregullatorë në treg, institucionet e administratës qendrore ose aktorët e tregut dhe shoqatat e krijuara me qëllim mbrojtjen e konsumatorëve nëpërmjet nënshkrimit të Memorandumeve të Mirëkuptimit. Janë nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi në mbrojtje të konkurrencës së lirë dhe efektive midis: Autoritetit të Konkurrencës dhe Bankës së Shqipërisë (në zbatim të nenit 70 të ligjit, AK-ja ka nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë dhe në këtë kuadër është organizuar edhe Workshop-i në lidhje me konkurrencën në sistemin bankar), Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ERE, MBUMK, Entit Rregullator të Telekomunikacioneve, Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Agjencisë së Prokurimeve Publike, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave etj.

Autoriteti i Konkurrencës ka synuar dhe synon drejt një bashkëpunimi të ngushtë edhe me autoritetet homologe në rajon dhe më gjerë. Në kuadër të këtij bashkëpunimi rajonal u nënshkrua Memorandumi i Mirëkuptimit midis Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës dhe Autoritetit Maqedonas të Konkurrencës. Nëpërmjet këtij memorandumi, të dy institucionet shprehën vullnetin dhe gatishmërinë që komunikimi, shkëmbimi i informacionit dhe të dhënat e tjera të nevojshme në respektim të detyrimeve ligjore, do të jenë një detyrim reciprok me përfitime vetëm ndaj publikut dhe interesave të tij.

Anëtarë të stafit të Autoritetit të Konkurrencës kanë marrë pjesë në kurse intensive trajnime, seminare, Workshop-e dhe konferenca rajonale dhe ndërkombëtare të organizuara nga OECD-ja, ICN-ja, (duke qene se AK-ja është anëtar me te drejta të plota në Rrjetin Ndërkombëtar të Konkurrencës) autoritetet homologe të Konkurrencës, projekti GTZ, ITAP,, UNCTAD, Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj, në të cilat është shkëmbyer eksperiencia, janë diskutuar rastet konkrete të shqyrtuara nga institucioni jonë në mbrojtje të

konkurrencës së lirë dhe efektive në treg duke shmangur praktikat anti-konkurrese për sa i përket abuzimit me pozitën dominuese, marrëveshjet e ndaluara dhe kontrollet e përqendrimeve, janë diskutuar rregulloret, udhëzuesit dhe njoftimet e KE-së në fushën e konkurrencës, etj. Autoriteti i Konkurrencës është angazhuar duke dhënë kontributin e tij në përgatitjen e materialeve në kuadër të studimeve të ndryshme që kryhen për çështjet e konkurrencës. Gjithashtu stafi i sekretariatit të AK-së ka kërkuar mbështetje nga programi TAIEX. (me anën e të cilit janë zhvilluar edhe vizita studimore dhe është siguruar pjesëmarrja në seminare).

Në bashkëpunim me GTZ-në janë organizuar :

- Workshop-i në Tiranë lidhur me advokacinë për ligjin dhe politikën kombëtare të konkurrencës me pjesëmarrje të gjerë të përfaqësuesve të pushtetit qendror dhe vendor, të studiove ligjore, të gjykatave , shkollës së magjistraturës dhe palë të treta të interesuara, si dhe
- Workshop-i në Autoritetin e Konkurrencës në lidhje me matricën e vlerësimit legjislativ, detyrim ligjor që duhet të kryejë Autoriteti i Konkurrencës.

## **IX. Synimet kryesore të punës për vitin 2008**

### ***IX. 1. Rritja e kapaciteteve administrative***

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2008 do të funksionojë me një strukturë të re organizative tashmë të plotë të burimeve njerëzore të mbështetur me burimet e nevojshme financiare. Synimi kryesor do të përqëndrohet në rritjen pavarësisë së institucionit nëpërmejt rritjes së nivelit të profesionalizmit duke iu përafuar standardeve të Autoriteteve homologe të Konkurrencës të vendeve të Bashkimit Evropian.

Për të përmbushur këtë synim, investimi në trajnimin dhe në rritjen e shkallës së njohurive dhe të eksperiencave të specialistëve përbën një nga veprimet që do të ndërmerren në Autoritetin e Konkurrencës. Plotësimi i strukturës së Sekretariatit me një staf relativisht të rritur kërkesën për trajnim dhe kualifikim të nëpunësve me qëllim rritjen e efikasitetit të institucionit dhe ngritjen në një stad më të lartë të standardeve të monitorimit, hetimit dhe procedurave të investigimit, si dhe të projekt-vendimeve të propozuara për vendimmarrje.

Në këtë kuadër do të punohet me institucione të rëndësishme si brenda ashtu dhe jashtë vendit, me ITAP, Universitetin e Tiranës, GTZ, OECD, TAEIX, UNCTAD, Drejtorinë e Përgjithshme të Konkurrencës në Komisionin Evropian, Rrjetin Ndërkombëtar të Konkurrencës, autoritetet simotra dhe donatorë të tjerë për të zhvilluar një proces të plotë të trajnimit të stafit me praktikën dhe eksperiencat më të mira në fushën e konkurrencës.

### ***IX.2. Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor në kuadër të MSA-së***

Autoriteti i Konkurrencës do të angazhohet në respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja dhe do të synojë përshtetjen e procesit të integritetit legjislativ. Në këtë mënyrë, Autoriteti ka përfshirë në planin e punës së vitit 2008 përmbushjen e detyrimeve të ndërmarra në kuadër të MSA-së të tilla si: përgatitja e udhëzuesve për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale dhe vertikale, dhe udhëzuesin për përqendrime horizontale, në përputhje me udhëzuesit e BE-së. Gjithashtu, janë parashikuar për t'u amenduar dhe përshtatur Rregullorja "Për gjokat dhe lehtësimin prej tyre", është parashikuar përgatitja e një udhëzimi për metodologjinë e vendosjes së gjobave, udhëzimi për përcaktimin e tregut përkatës nga këndvështrimi i ligjit të konkurrencës, udhëzim për vlerësimin e përqendrimeve vertikale dhe konglomeratit, udhëzim për procedurat hetimore (ku do të përfshihen marrëveshjet e rëndësishme të vogël, rregullat e aksesit në dokumentet e AK-së etj).

Në zbatim të detyrimit ligjor që rrjedh nga MSA-ja për përafrimin e legjislacionit primar dhe sekondar me direktivat, rregulloret dhe praktikave më të mira të Bashkimit Europian, Autoriteti i Konkurrencës ka parashikuar realizimin e vlerësimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Eksperiencia e akumuluar gjatë funksionimit të Autoritetit, karakteristikat e zhvillimit dhe të maturimit të tregut shqipëtar, dinamika e praktikave më të mira të BE-së në fushën e konkurrencës kanë paraqitur nevojën e rishikimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës me synimin kryesor rritjen e efciences reale të kuadrit detyruese të ligjit.

Për një vlerësim sa më real të të gjithë kuadrit të së drejtës së konkurrencës do të vazhdojë puna për rritjen e bashkëpunimit me entet rregullatorë, institucionet e administratës qendrore, si dhe me strukturat homologe të rajonit dhe më gjerë. Në këtë kuadër janë në proces hartimi draft/memorandumet e mirëkuptimit me Zyrën Shqiptare të të Drejtave të Autorit, Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Ministrinë e Drejtësisë etj.

### ***IX. 3. Monitorimi i tregut dhe hetimi i praktikave potenciale antikonkurruese***

Gjatë vitit 2008, Autoriteti i Konkurrencës ka përcaktuar synimet kryesore për monitorimin dhe studimin e kushteve të tregut për praktikave që kufizojnë, pengojnë dhe shtrembërojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.

Ndërhyrjet e Autoritetit të Konkurrencës do të shtrihen në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë për vetë natyrën e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” por edhe për shkak të rolit të rëndësishëm që kanë këto sektorë për ekonominë në tërësi dhe konsumatorët në mënyrë të veçantë. Gjithashtu, Autoriteti do të ndërhyjë në të gjithë ato raste që do të paraqesi vetë operatorët e tregut në kohë reale., apo nga sinjalet që do të merren gjatë analizave të tregut nëstudimin e shit/blerjeve dhe përqendrimeve të operatorve në të gjitha tregjet apo sektor të ekonomisë shqipëtare.

#### **IX.3.1 Hetimi i përgjithshëm në sektorin e energjisë**

Hetimi i përgjithshëm në sektorin e energjisë mbetet sfida kryesore e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2008 dhe për vitet e ardhshme jo vetëm për rëndësinë që ka ky sektor për ekonominë dhe cilësinë e jetës së konsumatorëve, por edhe për shkak të zhvillimeve të pritshme të privatizimeve të pritshme dhe liberalizimit në sektorin e energjisë elektrike. Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim me Entin Rregullator të Energjisë ka dhënë rekomandimet përkatëse në drejtim të liberalizimit të sektorit të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, ashtu siç dhe ka kërkuar një orientim drejt tregut të tarifave të energjisë elektrike.

Tregu i hidrokarbureve ka qenë dhe do të mbetet në axhendën kryesore të punës së Autoritetit të Konkurrencës për shkak të një konkurrence të pamjaftueshme në këtë treg, në mënyrë të veçantë në tregun e shumicës dhe për shkak të përqëndrimit të lartë që ekziston në këtë treg. Hapja e tregut për konkurrencë duke eliminuar maksimalisht sa është e mundur barrierat e hyrjes dhe monitorimi i sjelljes së operatorëve të rëndësishëm të këtij tregu përbëjnë objektivat kryesore të punës tonë të përditshme.

### **IX.3.2 Monitorimi i tregut financiar**

Autoriteti i Konkurrencës po monitoron me qëllim vëzhgimin e drejtëpërdrejtë jo vetëm të strukturave të tregut bankar por duke analizuar karakteristikat e tregut sipas produkteve të ofruara nga operatorët e këtij tregu. për të gjykuar nëse konkurrenca është e mjaftueshme si për produktet dhe shërbimet “retail” që ofrohen nga bankat ashtu dhe për aspekte të veçanta të ofertës së bankave për borxhin publik.

Autoriteti i Konkurrencës është në pritje të vendimit të formës së prerë të Gjykatës për të rifilluar hetimin në tregun e sigurimeve për shkak se një vendim në fuqi i Gjykatës së Shkallës së Parë në Tiranë e ka pezulluar këtë hetim. Autoriteti i Konkurrencës përfiton nga rasti të ndërgjegjësojë sistemin e drejtësisë se sa e rëndësishme është ndërhyrja në kohë e Autoritetit të Konkurrencës për rivendosjen e konkurrencës në treg pasi zgjatja me vite e proceseve gjyqësore jo vetëm zvarit punën e Autoritetit të Konkurrencës por edhe e nxjerr jashtë kontekstit hetimin e nisur.

### **IX.3.3 Hetimi i sektorit të telekomunikacioneve**

Një sektor i rëndësishëm që do të vazhdojë të jetë nën monitorimin dhe hetimin e vazhdueshëm të Autoritetit të Konkurrencës do të jetë edhe ai i telekomunikacioneve. Konkurrentët e tregut të shërbimeve telefonike dhe internetit po rishikojnë pozicionet e tyre në kushtet e reja të krijuara në treg dhe Autoriteti i Konkurrencës do të monitorojë në vijimi sjelljen e operatorëve të shpallur me fuqi të ndjeshme në treg por edhe të operatorëve alternativë që tashmë do të ofrojnë shërbimin e telefonisë fikse edhe në zonat urbane. Me liberalizimin e këtij shërbimi, një zhvillim ky shumë i mirëpritur në aspektet e rritjes së konkurrencës në treg, pritet të ndodhin një sërë zhvillimesh si në aspektet e rritjes së gamës së shërbimeve ashtu dhe të hyrjeve të investitorëve të fuqishëm të huaj në këtë treg dhe ripozicionimit të kompanive vendase që ofrojnë këto shërbime.

### **IX.3.4 Monitorimi i tregut farmaceutik**

Tregu farmaceutik do të monitorohet për të parë funksionimin në tregun e medikamenteve. Përsa i përket tregut në tërësi asnjëra nga ndërmarrjet e licensuara për prodhimin dhe/ose importin nuk gëzon e vetme pozitën dominuese në treg, por për produkte të caktuara, për shkak të specifikave dhe ekskluziviteteve që mund të jepen, do të monitorohet me kujdes ky treg dhe do të vlerësohen maksimalisht informacionet dhe ankimimet e mundshme. Parë në këndëvshtrimin e reformës rregullatore me theks drejt liberalizimit të mëtejshëm dhe shtimit të numrit të operatorëve në treg, duke parë dhe reagimin e pjesëmarrësve në shoqatat respektive, gjate vitit 2008, sektori antikartel do të bëjë evidentimin e praktikave që kufizojnë konkurrencën në treg.

### **IX.3.5 Ngritja e një sistemi të dhënash të monitorimit të tregut**

Një zhvillim i pritshëm dhe shumë i rëndësishëm për vitin 2008 do të jetë ndërtimi i një matrice me të dhëna historike përkatëse për sektorët e ekonomisë, një monitorim që do të shërbejë si bazë për analizën ekonomike të fenomeneve antikonkurrese dhe do të jetë në funksion të proceseve hetimore që do të ndërmarrë Autoriteti i Konkurrencës.

## ***IX.4. Ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e konkurrencës***

Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe i Politikës së Konkurrencës kërkon krijimin e një ambjenti të favorshëm për zhvillimin e aktivitetit të ndërmarrjeve publike dhe private dhe njohjen e zbatimin e rregullave të qarta të lojës.

Për shkak të kohës relativisht të shkurtër të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës, njohja e aktorëve të tregut me ligjin dhe politikën e konkurrencës mer rëndësi parësore në kushtet e Shqipërisë.

Komuniteti i biznesit i interesuar për një funksionim sa më normal të tregut dhe rritjen e produktivitetit, është një nga aleatët kryesorë të Autoritetit të Konkurrencës.

Për këtë arsye, promovimi i kultures dhe i advokatisë ndaj ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës në bashkëpunim me Unionin e Dhomave të Tregëtisë dhe shoqatat e biznesit do të realizohet nëpërmjet organizimit të tryezave të rrumbullakta me gjithë palët e interesit duke realizuar një shtrirje teritoriale në qytetet kryesore të vëndit.



Konsumatorët dhe shoqatat e tyre do të jenë një aleat tjetër i rëndësishëm i Autoritetit dhe ligji i Konkurrencës dhe zbatimi i tij është aleati më i mirë i konsumatorit për tju siguruar shërbimet dhe produktet më të mira në çmimet më të mira.

Vecoritë e zhvillimit ekonomik të vendit si dhe specifikat e tregut shqipëtar kanë shtruar si nevojë një bashkëpunim më të ngushtë me studjuesit e ekonomisë dhe të së drejtës së konkurrencës me qëllim përcaktimin e efekteve të këtyre vecorive në zbatimin e ligjit dhe të politikës së konkurrencës. Këto studime do të mundësohen në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, duke mundësuar jo vetëm rritjen e advokatisë dhe të kulturës për konkurrencën, por kryesisht për ndërtimin dhe zhvillimin e një platforme studimore për analizat e mëtejshme në tregjet konkrete.

Media do të vazhdojë të trajtohet si një aleat i Autoritetit të Konkurrencës për të përçuar mesazhet në publik.

Funksionimi i faqes zyrtare të internetit për rritjen e aksesit për informacionin në lidhje me veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës do të rrisë transparencën e vendimeve të Komisionit të Konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës do të vijojë edhe gjatë vitit 2008 praktikën e botimit të Raportit Vjetor, Buletinit të Vendimeve, kuadrit ligjor dhe rregullator dhe broshurave informuese mbi rëndësinë e konkurrencës në rritjen e produktivitetit, rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe të mirëqënies së konsumatorëve.

### ***IX.5. Konsolidimi i marrëdhënieve ndërkombëtare të Autoritetit të Konkurrencës***

Autoriteti i Konkurrencës do të jetë aktiv në procesin e integritimit evropian dhe forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me ndërkombëtarët dhe institucionet homologe të konkurrencës do të jetë një nga prioritetet e punës gjatë vitit 2008. Autoriteti i Konkurrencës do të synojë që nëpërmjet nënshkrimit të memorandumëve të mirëkuptimit me institucionet homologe si me Autoritetin Bullgar, të bashkëpunojë konkretisht në hetimin e rasteve potenciale anti-konkurrese. Anëtarët e stafit të AK-së do angazhohen nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në konferencat, seminarët dhe trajnimet e zhvilluara në fushën e konkurrencës.

Nëpërmjet aplikimeve në programin TAIEX dhe me ndihmën e tij:

- do të organizohet një Workshop në Tiranë i cili do të ketë për qëllim ndërgjegjësimin e publikut për Ligjin e Konkurrencës dhe Politikën Kombëtare të Konkurrencës si dhe bashkëpunimi midis AK-së dhe Enteve Rregullatorë.

- do të mundësohet ardhja e një eksperti në fushën e konkurrencës i cili do të ndihmojë anëtarët e stafit të AK-së në hetimin e përgjithshëm të ndërmarrë në sektorin e energjisë elektrike.

Nëpërmjet, pjesëmarrjeve aktive duke dhënë kontribute në publikimet e paraqitura nga UNCTAD, seksioni i konkurrencës; Global Competition Review; Competition and Antitrust Review, 2008 (Botim i Euromoney); Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës synon të realizojë konsultën me ekspertët ndërkombëtar në lidhje me praktikën e ndjekura nga autoriteti shqipëtar.